



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 652/6 Prot.

Tiranë, më 09 . 09 . 2025

V E N D I M

Nr. 210 , Datë 09 . 09 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 94 Regj., datë 17.04.2025², të shtetasve A. dhe S. M³, kundër Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të: “racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës të shtetasve A. dhe S. M (bashkëshortë), në mes të tjerash, parashtrohet se:

“A. M (49 vjeç) dhe S. M (44 vjeç) janë të martuar dhe u përkasin komunitetit rom. Ata kanë lindur dhe banojnë në Tiranë. Asnjëri nga të dy nuk ka ndjekur shkollën, (as atë filllore) dhe për rrjedhojë nuk kanë mësuar kurrë të shkruajnë e të lexojnë. Gjatë gjithë jetës së tyre janë përballur me

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Regjistruar fillimisht me datë 17.04.2025 dhe plotësuar me datë 07.05.2025.

³ Përfaqësuar para KMD-së nëpërmjet Av. A. D, sipas Prokurës së Posaçme me nr. repertori 1920 dhe nr. koleksioni 642, datë 03.03.2025.2025, të Noteres M. D.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

vështirësi për të gjetur punë dhe kanë qenë të detyruar të shfrytëzojnë çdo mundësi për të siguruar të ardhmen për mbijetesë. Aktualisht, ata janë të punësuar në një treg me rroba të përdorura, një punë kjo me kohë të pjesshme 4 orë në ditë, me një pagë e cila nuk mbulon nevojat e tyre bazë, si: qiraja, ushqimi, veshmbathjet dhe shpenzimet e tjera jetësore.

Në këto kushte, ankuesit vendosën të aplikojnë për ndihmë ekonomike, duke qenë se plotësojnë kriteret për përfitimin e saj.

Me datë 03.03.2025, ata janë paraqitur pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, ku banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike, si institucioni publik përkatës që trajton këto kërkesa.

Punonjësja e kësaj Njësie Administrative, iu kërkoi të dorëzonin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Certifikatë familjare;*
- b) Vërtetim pronësie nga ASHK-ja;*
- c) Vërtetim pune.*

Dokumente këto, të cilat parashikohen në VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Për të siguruar dokumentacionin sipërcituar, ishte i nevojshëm përdorimi i portalit e-Albania, por ankuesit nuk dispononin një llogari në këtë platformë dhe për shkak të mungesës së njohurive në të lexuar dhe në të shkruar, nuk ishin në gjendje as të kuptonin dhe as të përdornin platformën.

Pavarësisht dijenisë për këtë fakt, pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, nuk iu ofrua asnjë ndihmë për të realizuar aplikimin, por u mjaftuan në dhënien e përgjigjes standarde: “Herën tjetër sillni dokumentet për të kryer aplikimin”.

Vetëm përmes ndihmës së personave të tretë, ankuesit, nëpërmjet komunikimeve me e-mail me helpdesk, mund të hapnin llogarinë në e-Albania. Kjo procedurë ka marrë kohën e saj (rreth një javë) dhe duke marrë parasysh që të dy janë në pamundësi, asistimi ka qenë i nevojshëm për të aplikuar për ndihmën ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë dokumentet e kërkuara. Ky hap ka qenë i detyrueshëm për të nxjerrë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për ndihmë ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë certifikatën familjare, vërtetim page, vërtetimin për pronësi dhe vërtetimin negative pensioni për anukesit.

Në datën 3 mars 2025 është kryer aplikimi për vërtetim pronësie online, ku pagesa e shërbimit është kryer me postë dhe fatura është bashkëngjitur në platformë. Që prej kësaj date e deri më sot ky shërbim nuk është marrë nga ankuesit, pa pasur ndonjë arsye të argumentuar.

Koha e humbur nga vajtje-ardhjet nëpër sportele pa u ndihmuar për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe vështirësive në aksesimin e dokumentacionit të kërkuar, bëri që

ankuesit të mos përfundonin procedurën në kohën e duhur. Kjo vonesë çoi në humbjen e mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike në muajin mars 2025.

Subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri:

“Konstatimin e diskriminimit të ankuesve, nga Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, për shkak të racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale.

Detyrimin e Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë që të marrë masa për të siguruar mjetet dhe mënyrën e ofrimit të asistencës dhe ndihmës për të gjithë personat, të cilët nuk mund të marrin vetë dhe në mënyrë të pavarur shërbimet on-line nëpërmjet e-Albania.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes civile” dhe “gjendjes shëndetësore” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për

cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 652/2 prot., datë 09.05.2025, ka kërkuar nga Njësia Administrative Nr.5/Bashkia Tiranë, informacion dhe dokumentacion provues.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1651/1 prot., datë 28.05.2025, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë, ka dërguar parashtrimet e saj, duke informuar ndër të tjera Komisionerin, se:

“...Z. A. dhe znj. S. M i janë drejtuar Njesisë Administrative Nr.5/Bashkia Tiranë (Sektorit të NJVNR) për të kryer aplikim për ndihmë ekonomike. Pasi janë informuar për dokumentacionin përkatës në bazë të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, për aplikim për ndihmë ekonomike janë orientuar dhe ndihmuar për të siguruar dokumentacionin bazë për kryerjen e aplikimit të ndihmës ekonomike. Ju bëjmë me dije se, një nga kriteret bazë për aplikim është paraqitja paraprakisht pranë Zyrës të Punës (institucion që nuk është në varësi të Njesisë Administrative) për të gjithë personat e moshës 18 – 60 vjeç, për t’u regjistruar si punëkërkues të papunë dhe për t’u orientuar në tregun e punës.

Pasi kryhet ky proces, mund të aplikohet për përfitimin e ndihmë ekonomike, pasi në të kundërt, në mungesë të regjistrimit pranë Zyrës të Punës, edhe nëse bëhet aplikimi në sistem, pas verifikimeve nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH), familja nuk del përfituese dhe nuk ka të drejtë riaplikimi për 6 muaj.

Sqarojmë se, pas bisedës së kryer me znj. S, ajo tregoi se nuk ka bërë asnjë ankesë ndaj punonjësve të Njesisë Nr.5, për mosrespektim ndaj saj apo familjarëve të saj, si dhe mungesës së ndihmës për

paraqitjen e dokumentacionit përkatës. Znj. S tregon se për shkak se djali i saj nuk është regjistruar akoma pranë Zyrës së Punës si punëkërkues i papunë, nuk janë paraqitur më pranë Njesisë Administrative Nr. 5, për të bërë aplikimin për ndihmën ekonomike.

Ju informojmë se, për sqarim të rastit, nuk na janë vënë në dispozicion dhe do të kërkonim që t'i kishim, dokumentacionin, si: certifikatë familjare, prokurë e posacme, komunikimi me e-mail misdis ankuesve dhe helpdesk@e-albania.al, vërtetime page (2), vërtetim negativ pensioni (2), aplikim ASHK dhe mandat postar, ankim ASHK.

Në Njësine Administrative nr. 5, ofrohet ndihmë për përdorim të e-Albania, për të gjithë personat që nuk dinë të përdorin shërbimet online, nga personel që ndihmon për të bërë aplikime, si: certifikata, ndihmë ekonomike, etj. Edhe Zyra e Gjendjes Civile ofron mbështetjen e duhur për të ndihmuar qytetarët për të kryer aplikimet online.

Sqarojmë se asnjë qytetar që është drejtuar apo do të drejtohet pranë zyrave të Njesisë Administrative Nr. 5/Bashkia Tiranë, i çdo lloj etnie, race dhe kulture nuk ka mbetur pa u ndihmuar, gjithmonë mbështetur në legjislacionin në fuqi.”

- 3.** Pas njohjes me sa më sipër, pala ankuese nëpërmjet shkresës datë 12.06.2025, ka depozituar observacion lidhur me parashtrimet e sjella nga ana e Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë, duke evidentuar, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

“Së pari, ankuesja është kontaktuar nëpërmjet telefonit, nga stafi i Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë, në mënyrë të papërshtatshme dhe në keqbesim, për shkak se institucionit i ishin bërë të ditura të dhënat e kontaktit të përfaqësueses ligjore (avokates) së ankueses, dhe jo të vetë ankueses. Komunikimi i drejtpërdrejtë me ankuesen, jashtë çdo rruge zyrtare dhe duke anashkaluar avokaten e saj, nënkupton një përpjekje të qartë për të ushtruar presion të tërthortë mbi të, me qëllim tërheqjen nga ankimi.

Së dyti, referenca që i bëhet faktit se :”Znj. S nuk ka paraqitur ankim”, mbetet e paqartë në funksionin e saj...Nuk është aspak e qartë pse ky institucion, i cili nuk ka kontaktuar asnjëherë më parë ankuesit, në momentet kur atyre u nevojitej ndihmë reale për të përfutur një shërbim publik, është treguar tepër i zellshëm për t'i kontaktuar vetëm në kontekstin e një ankimi ndaj institucionit.

Së treti, në përgjigje pohohet se njësia administrative ofron ndihmë për shërbimet elektronike. Në këtë drejtim nuk është sqaruar se mbi çfarë baze ofrohet kjo ndihmë.

Në mungesë të çdo dokumentacioni apo reference konkrete, deklaratat e përgjithshme mbi ofrimin e asistencës mbeten të paqëndrueshme dhe pa vlerë për qëllimet e shqyrtimit të kësaj ankese. Pohime të tilla që ofrojmë ndihmë sepse kemi dëshirë, por pa prova dhe bazë ligjore janë të panevojshme për efekt të këtij ankimi.

Së katërti, Njësia Administrative, në kundërshtim me objektin e ankimit, ka përfshirë në përgjigje, informacione të panevojshme mbi situatën personale të djalit të ankueses, përfshirë edhe çështjen e papunësisë së tij. Këto të dhëna nuk kanë lidhje me përmbajtjen dhe qëllimin e ankimit dhe përbëjnë devijim të qëllimshëm nga çështja kryesore që lidhet me sjelljen dhe mungesën e veprimeve të institucionit...”

4. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 652/4 prot., datë 02.07.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

5. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 15.07.2025, në mungesë të subjekteve ankues⁵ dhe përfaqësueses me autorizim⁶, të Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, znj. A. K, punonjëse pranë kësaj Njësie.

Përfaqësuesja e Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, u qëndroi të njëjtave pretendime⁷ si ato të bëra të njohura shkresërisht në parashtrimet e depozituara paraprakisht pranë KMD-së, duke theksuar ndër të tjera, se, znj. M i është ofruar shërbimi pranë Njesisë, por nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm dhe i është bërë me dije se, duhej paraqitur edhe vërtetimi nga Zyra e Punës për të birin, i cili është i moshës madhore dhe për përfitimin e ndihmës ekonomike duhet vërtetim (për të) si punëkërkues i papunë. Në momentin që ka marrë këtë informacion ajo është larguar me pretendimin se do sillte dokumentet përkatëse por nuk është paraqitur më pranë Njesisë për aplikimin.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, si dhe në analizë të legjislacionit poshtëcituar, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.

⁵ Apo përfaqësuesit të tyre ligjor.

⁶ Autorizim i Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, me nr. 2477 prot., datë 04.06.2025.

⁷ Depozituar shkresërisht gjatë seancës.

Neni 7 i këtij ligji parashikon shprehimisht se:

“Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

- a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;*
- b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;*
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;*
- ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;*
- d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.”*

Neni 12, pikat 1-2, të ligjit të sipërcituar parashikojnë gjithashtu se ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.

Kategoritë e individëve që mund të aplikojnë për të përfitur ndihmë ekonomike, si dhe mënyrën se si bëhet pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike, përcaktohet shprehimisht në nenin 16, pikat 1-3, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet se:

1. Kërkesa për të përfitur ndihmë ekonomike bëhet nga:

- a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;*
- b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;*
- c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.*

2. Aplikimi për të përfitur ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në Vendimin nr. 956, datë 7.12.2016, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike” parashikohet se formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin

e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Në këtë kontekst, është pikërisht sistemi zbatues i kësaj formule, që për zgjedh familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është miratuar Vendimi nr. 597, datë 04.09.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar.

VKM-ja sipërcituar, përcakton respektivisht si vijon:

I. Subjektet, kriteret dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike.

1. Ndihma ekonomike shpërndahet sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;

b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

4. Për të përfituar ndihmë ekonomike, subjektet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

4.1. Për familjet në nevojë, kryetari i familjes/njëri nga anëtarët madhorë, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kërkojnë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin, duke paraqitur, si më poshtë vijon:

a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantëve.

b) Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës /vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.

c) Për rastet që janë në proces zgjidhjeje martese dhe ende nuk ka një vendim gjykatë të formës së prerë, dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4.1, të këtij kreu paraqitet i ndarë nga secili

bashkëshort. Krahas këtij dokumentacioni paraqitet edhe vërtetimi i gjykatës që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martesë.

ç) Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuara, që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, të këtij kreu, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror merr vërtetimin e komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nëpërmjet ndërveprimit me Regjistrin Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.

d) Shfuqizuar.

dh) Për fëmijët e familjeve në nevojë që vaksinohen, paraqesin edhe fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer, sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve, për të përfituar pagesën shtesë.

e) Për familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë anëtarë në moshë aktive pune, që ndjekin arsimin e lartë, krahas dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4.1, paraqesin edhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni arsimor, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar një herë brenda një viti shkollor.

f) Familjet në nevojë, që në përbërje të tyre kanë anëtarë madhorë, paraqesin dy herë në vit vërtetimin për hyrjedaljet nga territori shqiptar, të lëshuar nga portali “e-Albania”.

II. Procedura e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike.

1. Administratori shoqëror identifikon familjet e individët në nevojë, i informon për regjistrimin si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës dhe për të vijuar me procedurat e punësimit përpara aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike. Administratori shoqëror referon për t'i regjistruar si punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës anëtarët madhorë në moshë aktive pune të familjeve në nevojë, që jetojnë në fshat, të cilët kanë firmosur vetëdeklarimin se janë të gatshëm për punë pranë zyrave përkatëse të punës. Individët e referuar paraqiten në zyrën e punës pranë vendbanimit të tyre brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme: a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për: i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; ii) llojin e banesës; iii) pasuritë/asetet familjare; iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

1.1 Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat për familjet që aplikojnë për herë të parë për ndihmë ekonomike. Aplikimi vlerësohet nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar pas ofrimit nga zyra e punës të ofertave të përshtatshme të punësimit për anëtarët madhorë të familjeve aplikuese, të gatshëm për punë, por jo më vonë se deri në fund të muajit të aplikimit.

2. Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda 20 (njëzet) ditëve të muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.1 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, për familjet që aplikojnë për herë të parë, kryen verifikimin në terren pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror.

3. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

4. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike.

5. Administratorët shoqërorë janë të detyruar që dokumentet e përcaktuara në pikën 4, të kreut I, dhe në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të kreut II, të këtij vendimi, t'i ruajnë ato sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.

6. Ndryshimi i vendbanimit të përfituesve të ndihmës ekonomike shoqërohet me transferimin e dokumentacionit pranë bashkisë/njësisë administrative të vendbanimit të ri.

7. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki dërgon, në formë elektronike, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për trajtim me ndihmë ekonomike, brenda datës 15 të çdo muaji, sipas formatit në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

.....

11. Përfshihen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtëmuajore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes që jetojnë në të njëjtën strehë, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë-nënë;
- b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare sh.a., me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkak të arsyeshme, si ato shëndetësore apo fatkeqësi.
- c) Refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;
- ç) Fsheh informacionin apo kryen deklaram të rremë;

d) Nuk paraqiten për deklarin dhe/ose nuk deklarojnë ndryshimet e situatës social-ekonomike çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi, dhe të anëtarëve të familjes, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara, invalidë pune ose të moshuar, të cilët janë në pamundësi lëvizjeje;

dh) Refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

e) Kanë anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat;

ë) Anëtarët në moshë aktive pune, të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të familjeve që kanë anëtarë, që ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç.

12. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë njëvjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Është në moshë aktive pune dhe refuzon ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

b) Punësohen dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, me përjashtim të rasteve kur zgjidhja e kontratës bëhet nga ana e punëdhënësit;

c) Ka kryer më shumë se një deklarin të rremë;

ç) Ato familje, të cilat rezultojnë me të ardhura dhe kushte të mira social-ekonomike.

13. Pagesat e ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në kreun III, të këtij vendimi, paguhen nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njësive administrative ku ka vendbanimin përfituesi. Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/komisionohen.

14. Vërtetimi për përfitimin ose jo të ndihmës ekonomike lëshohet nëpërmjet portalit “e-Albania”.

Bazuar në sa më sipër, Njësia Administrative si organi kompetent, pranë njësisë vendore/bashkisë për trajtimin e aplikimeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, ushtron një funksion me natyrë të dyfishtë në ofrimin e këtij shërbimi.

Në fazën fillestare, aplikimi realizohet nga individët, fizikisht, përmes paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar, i cili më pas përpunohet dhe hidhet në sistem në mënyrë elektronike nga administrata përkatëse/ punonjësi i njësisë administrative përkatëse.

Ndërsa, faza e mëtejshme e ndjekjes së statusit të aplikimit, lidhet me komunikimet e tjera, si marrja e përgjigjes për pranimin apo refuzimin e tij.

Përfaqësuesja ligjore e subjekteve ankues, ka pohuar para KMD-së, se: *“Për të siguruar dokumentacionin sipërcituar, ishte i nevojshëm përdorimi i portalit e-Albania, por ankuesit nuk*

dispononin një llogari në këtë platformë dhe për shkak të mungesës së njohurive në të lexuar dhe në të shkruar, nuk ishin në gjendje as të kuptonin dhe as të përdornin platformën.

Vetëm përmes ndihmës së personave të tretë, ankuesit, nëpërmjet komunikimeve me e-mail me helpdesk, mund të hapnin llogarinë në e-Albania. Kjo procedurë ka marrë kohën e saj (rreth një javë) dhe duke marrë parasysh që të dy janë në pamundësi, asistimi ka qenë i nevojshëm për të aplikuar për ndihmën ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë dokumentet e kërkuara. Ky hap ka qenë i detyrueshëm për të nxjerrë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për ndihme ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë certifikatën familjare, vërtetim page, vërtetimin për pronësi dhe vërtetim negativ pensioni për ankuesit.

Në datën 3 mars 2025 është kryer aplikimi për vërtetim pronësie online, ku pagesa e shërbimit është kryer me postë dhe fatura është bashkëngjitur në platformë. Që prej kësaj date e deri më sot ky shërbim nuk është marrë nga ankuesit, pa pasur ndonjë arsye të argumentuar.

Koha e humbur nga vajtje-ardhjet nëpër sportele pa u ndihmuar për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe vështirësive në aksesimin e dokumentacionit të kërkuar, bëri që ankuesit të mos përfundonin procedurën në kohën e duhur. Kjo vonesë çoi në humbjen e mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike në muajin mars 2025.”

Për sa më sipër, rezulton se pretendimet e ngritura nga shtetasit A. dhe S. M, kundrejt Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë, lidhen me fazën fillestare të aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike dhe jo me refuzimin për të qenë përfitues të ndihmës ekonomike.

Nga aktet e depozituara dhe pohimet e palëve në këtë proces, rezulton se:

Me datë 03.03.2025, subjektet ankues (A. dhe S. M) janë paraqitur pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, ku ata banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nga ana e punonjësës së kësaj Njësie, u është kërkuar të dorëzonin dokumentacionin respektiv, sipas kriterëve të kërkesave që parashikohen në VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar.

Pra, në fazën fillestare, aplikimi realizohet duke u paraqitur individët fizikisht pranë njesisë administrative ku kanë banesën, si dhe përmes paraqitjes prej tyre të dokumentacionit të kërkuar, i cili më pas përpunohet dhe hidhet në sistem.

Në këtë kontekst, bazuar në sa më sipër, evidentohet se, pengesa reale që ka pamundësuar efektivisht aplikimin e shtetasve A. dhe S. M për fazën fillestare lidhur me përfitim të ndihmës ekonomike, ka qenë mosparaqitja e dokumentacionit të nevojshëm, për të cilin dhe janë sqaruar. Ata nuk kanë ngritur pretendime për mos dhënie informacioni apo mosqarim lidhur me të nga ana e punonjësve të kësaj Njësie.

Pretendimi i tyre për humbjen e mundësisë për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike në muajin mars 2025, lidhet me mungesën dhe pamundësinë e aksesimit të tyre në portalin e-Albania për marrjen e dokumentacionit respektiv, i cili gjenerohet nga institucione të tjera, sipas kompetencave dhe fushës së tyre të përgjegjësisë, siç konkretisht kanë referuar aplikimin e kryer për vërtetim pronësie online, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. *(mosmarrjen e dokumentit në kohë)*

Në këtë kontekst, rezulton se Njësia Administrative, në këtë rast, nuk ka ndikuar në refuzimin e ankuesve për aplikimin lidhur me fazën fillestare, fazë e cila lidhet vetëm me aplikimin online në sistem *(plotësimin dhe hedhjen e të dhënave dhe dokumentacionit përkatës)* i cili realizohet nga punonjësi i Njesisë, pasi rezulton se ky aplikim nuk është kryer për shkak të mos paraqitjes të dokumentacionit respektiv të kërkuar për këtë fazë, nga ana e subjekteve ankues.

Ndërkohë pretendimet për pamundësinë e marrjes së këtyre dokumenteve nga institucionet komptente që i posedojnë dhe gjenerojnë, subjektet ankues i kanë adresuar në kuadër të ankesave të tjera pranë KMD-së, kundrejt subjekteve përgjegjëse si, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe Zyra e Gjendjes Civile/Bashkia Tiranë.

Për rrjedhojë, Komisioneri, nuk ka analizuar këto pretendime, pasi për to do të shprehet me vendimet përkatëse të ankesave respektive, por *vetëm pretendimet e subjekteve ankues lidhur me momentin fillestar të aplikimit*, gjatë të cilit janë informuar nga punonjësi i Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë, lidhur me dokumentacionin që duhet të paraqisnin, në mënyrë që aplikimi të ishte i plotë dhe të mos u refuzohej nga sistemi për mangësi të tij (respektivisht sipas sqarimeve përkatëse).

Plotësimi dhe depozitimi i dokumentacionit përkatës është parakusht për aplikimin për ndihmë ekonomike dhe sigurimi i tij bëhet nga aplikantët e interesuar.

Lidhur me këtë fazë fillestare të aplikimit për përfundimin e ndihmës ekonomike, ku kërkohet paraqitja fizike e aplikantëve dhe depozitimi i dokumentacionit respektiv, Komisioneri vlerëson se, ankuesit nuk kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm *(as paraprakisht dhe as në vijim, pasi janë sqaruar se çfarë dokumentesh duhen depozituar)*, në mënyrë që të kalohej tek faza tjetër e aplikimit. Kjo situatë çoi në përjashtimin e familjes nga ndihma ekonomike, pasi depozitimi i dokumentacionit të kërkuar është një kriter i rëndësishëm për të përmbushur kërkesat ligjore dhe administrative për të pasur akses në mbështetje financiare dhe nuk ka ardhur si pasojë e mosveprimit apo refuzimit të punonjësve të kësaj Njësie.

Nga ana tjetër, Komisioneri vëren se, administratorët shoqërorë/njësitë administrative mbajnë përgjegjësinë për mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit sipas kërkesave të akteve të mësipërme ligjore e nënligjore.

Në rastin e subjekteve ankues, punonjësi i Njesisë, i ka informuar në mënyrë të detajuar për dokumentacionin e nevojshëm (*si dhe për rëndësinë e regjistrimit të djalit të tyre, i moshës madhore si punëkërkuar i papunë pranë Zyrës së Punës*), pasi përmbushja e depozitimi i tij është parakusht dhe do të ndihmonte në përmbushjen e kërkesave ligjore për të siguruar aksesin e familjes në skemën e ndihmës ekonomike dhe do të parandalonte pasojat e mundshme nga mungesa e regjistrimit.

Në këtë kontekst, lidhur me pretendimet për fazën fillestare të aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, të cilat janë objekt i kësaj ankese, ankuesit nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, pasi punonjësit e saj kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e parashikuara *për fazën fillestare* të aplikimit për ndihmë ekonomike.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet ankues, nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e kësaj Njësie, ardhur për shkaqet e pretenduara.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të "*racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale*", të shtetasve A. dhe S. M, lidhur me fazën fillestare të aplikimit për përfitimimin e ndihmës ekonomike, nga ana e Njesisë Administrative Nr. 5, Tiranë/Bashkia Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI

Robert GAJDA